



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRES

PROJEKTVENDIM

NR____, DATË__/_/ 2025

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026 DHE
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja "b", pika 1.3 shkronja "c" nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat "ç" dhe "dh", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 6, shkronjat "ç" dhe "d", nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neneve 6, 15, 17 dhe 32, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; nenit 2, shkronja "c" dhe nenit 5, shkronjat "a" dhe "d", Ligjit "Për buxhetin e vitit 2026", ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të Vendimit nr.503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.93 datë 28.10.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë së Durrësit", të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.94 datë 28.10.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të njësive administrative të Bashkisë së Durrësit", të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.95 datë 28.10.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës", të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.96, datë 28.10.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë bashkiake Durrës", Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.8 dt.28.02.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028", kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak,

TË VENDOSË :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Durrës për periudhën 2026-2028, si më poshtë vijon:

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë Durrës për vitet 2026-2028 është si më poshtë:

ne lekë

	Burimet Buxhetore	2026 Parashikimi	2027 Parashikimi	2028 Parashikimi
1	Të ardhura nga burimet e veta	2,877,819,700	2,886,205,400	2,860,014,500
2	Transferta nga buxheti qendror	2,567,953,993	2,652,919,589	2,742,797,912
3	Të ardhura nga taksat e ndara	407,050,000	415,050,000	420,050,000
4	Huamarrja	-	-	-
5	Trashëgimi nga viti i kaluar	1,000,000,000	900,000,000	900,000,000
	TOTALI	6,852,823,693	6,854,174,989	6,922,862,412

1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë Durrës për vitet 2026-2028 është si më poshtë :

në lekë

Nr.	Shpenzimet	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028
1	Shpenzime personeli (llog.ekon. 600,601)	2,031,917,335	2,031,917,335	2,031,917,335
2	Shpenzime korrente (llog.ekon.602,603,604,605,606,609,651)	1,772,995,819	1,772,995,819	1,772,995,819
3	Shpenzime kapitale te brendshme (llog.ekon. 230,231)	3,047,910,539	3,049,261,835	3,117,949,258
4	Shpenzime kapitale te huaja (llog.ekon. 230,231)	-	-	-
	TOTALI SHPENZIMEVE	6,852,823,693	6,854,174,989	6,922,862,412

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 , si më poshtë:

2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë Durrës sipas Pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.2. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Durrës sipas Pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.3. Të miratojë planin e shpenzimeve të Bashkisë Durrës për vitin 2026 sipas Pasqyrës nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.4. Të miratojë planin e shpenzimeve për vitin 2026 sipas burimit të financimit si më poshtë vijon:

2.4.1 Shpenzimet me burim financimi nga transferta sektoriale janë sipas pasqyrës nr.3.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.4.2 Shpenzimet me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme janë sipas pasqyrës nr.3.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi








2.4.3 Shpenzimet me burim financimi nga të ardhurat (kapitull 5) janë sipas pasqyrës nr.3.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- 2.5. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale të Bashkisë Durrës nga burimet e veta për vitet 2026-2028 sipas pasqyrës nr.4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.6. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar në Ndërmarrjen Komonale Plazh për vitin 2026 për punonjësit sezonal për pastrimin e zonave bregdetare gjatë sezonit turistik miratohen me pagë bruto mujore 45000 lekë dhe një afat 5(pesë) mujor.
- 2.7. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për punonjësit e projektit të arkivës për vitin 2026 miratohen me pagë bruto mujore sa paga bazë minimale mujore në shkallë vendi dhe një afat 1 vjekar.
- 2.8. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për punonjësit e Qendrës Rinore për vitin 2026 miratohen me pagë bruto mujore sa paga bazë minimale mujore në shkallë vendi dhe një afat 1 vjekar.
- 2.9. Fondi rezervë për vitin 2026 do të jetë 70,000,000 lekë, fondi i kontigjencës do të jetë 20,000,000 lekë. Këto fonde do të përdoren me vendime të veçanta të Këshillit Bashkiak.
- 2.10. Fondi rezervë për rritjen e pagave prej 190,050,899 lekë i alokuar në formën e transfertës së pakushtëzuar do të përdoret me vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave që do të miratohen në funksion të rritjes së pagave për punonjësit e organeve të vetëqeverisjes vendore .
- 2.11. Kuota për Qarkun për vitin 2026 do të jetë 40.000.000 lekë.
- 2.12. Pagesat mujore të sportistëve pranë Klubit të Shumësporteve Durrës, të anëtarëve të Orkestrës Frymore dhe Orkestrës së Harqeve do të jenë sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.13. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për cdo program buxhetor për vitin 2027 janë sipas pasqyrës nr.5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.14. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik për cdo program buxhetor për vitin 2028 janë sipas pasqyrës nr.6, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.15. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2026.
3. Miratimin e dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Durrës, që i bashkëlidhet këtij projektvendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë, Ndërmarrjet dhe Insitucionet në varësi të Bashkisë Durrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

GRUPI PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK NË BASHKINË DURRËS

- | | | | |
|-------------|--------|---------|--------------------|
| 1. Emiriana | Sako | Kryetar | Kryetar i Bashkisë |
| 2. Gentian | Kallmi | Anëtar | Zëvendëskryetar |
| 3. Elio | Jani | " | Zëvendëskryetar |
| 4. Egert | Hoxha | " | Zëvendëskryetar |

5. Almiva	Llaçi	"	Dr. Drejtoria e Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë	
6. Alneida	Rroshi	"	Dr. Drejtoria Ligjore	
7. Roni	Shqiopa	"	Dr. Drejtoria e taksave dhe Tarifave Vendore	
8. Ina	Ferra	"	Dr. Drejtoria Ekonomike	
9. Ardian	Iljazaj	"	Dr. Drejtoria e Shërbimeve Publike	
10. Alda	Zyferi	"	Dr. Dr. e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike	
11. Valbona	Qiriako	"	Dr. Drejtoria e Buxhetit	
12. Brunilda	Gripshi	"	Dr. Drejtoria e Burimeve Njerëzore	
13. Ana	Hoxha	"	Dr. Dr. e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit Territorial	
14. Lorenc	Smajli	"	Dr. Drejtoria e Turizmit	
15. Migena	Muhaj	"	Dr. Dr. e Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Kom.Fetare	
16. Diola	Xhango	"	Dr. Drejtoria e Shërbimit Social	
17. Xhuljo	Llazo	"	Dr. Drejtoria e Informatikës dhe Dixhitalizimi	



BASHKIA Durrës

**RELACION MBI BUXHETIN E VITIT 2026
DHE
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM
2026 – 2028**

Djetor 2025

Përmbajtja

1. HYRJE	3
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	3
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	5
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË	7
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	7
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË	7
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË	9
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË	9
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	11
4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË DURRES 2026-2028	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË DURRES NË VITET 2026-2028	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.3 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektive të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektive të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektive të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektive të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektiveve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësi vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2026-2028 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia e Durrësit është pjesë e Qarkut të Durrësit dhe përbëhet nga 11 njësi administrative, nga të cilat gjashtë janë në qytet (ish rajonet) dhe pesë janë ish komunat : Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz. Bashkia Durrës ka 14 lagje në qytet dhe 39 fshatra.

Bashkia Durrës ka sipas Gjendjes Civile 344,245 banorë ose 110,400 familje, ku 68% e popullsisë është urbane, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të mësipërme është 1017 banorë/km²

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë

Pasuria me e madhe e Bashkisë Durrës janë banorët e saj. Bashkia nderton strategjinë e zhvillimit me ta dhe për ta. Komunikimi i rregullt me qytetarët, bashkëpunimi me universitetin dhe me shkollat, mbështetja e iniciativave qytetare për zhvillimin socio-ekonomik të bashkisë është prioritet i Bashkisë.

Historikisht Durrësi ka ndjekur evolucionin e fluksit të shkëmbimeve Evropë – Bizant / Lindje. Territori shqiptar është bërë relevant vetëm 100 vjetet e fundit. Porti si platformë shkëmbimesh I ka ofruar qytetit flukset e jetësore: mallra, energji, ujë, burime natyrore, ushqime etj. Qyteti i ka ofruar këtyre flukseve, shërbimet e nevojshme mbështetëse për aktivitetet ekonomike perkatëse. Bashkia e Re, i shton Qytetit-Port dhe territorin bujqësor dhe disa mini-zona urbane.

Komponenti urban i strategjisë e shikon Bashkinë Durrës si më poshtë:

- Rrashbulli si lagje e Durrësit: tashmë një fakt në terren;
- Qyteza KIS (Katund i Ri – Sukth): krijon kontinuitet urban, sinergji, ulje shpenzimesh, etj;
- Pol sub-urban Shkafanë – Kullë: përgjigje ndaj zhvillimit të Shkafanës dhe pozitës gjeografike të Kullës në qendër të akseve lidhëse të Bashkisë së Re;
- Keneta, si zonë mbështetëse e Zonës Industriale Porto Romano: zonë e urbanizuar për banim e shërbime mbështetëse për 30,000 të punësuarit e ZIPR;
- San Pietro / Lalez: për turizëm cilësor;
- Kallmi si turizëm elitë & mushkeri e blertë e Durrësit

Komponenti turistik i strategjisë e shikon Bashkinë Durrës si më poshtë:

- Durrësi: vitrina e Shqipërisë për vizitorët e krocierave;
- Mbrojtja dhe promovimi i parqeve natyrore / valorizimi i hinterlandit për vizitorët lokalë dhe kombëtarë (nga Tirana);
- Turizmi i detit & reres: cilësor në Lalez dhe Kallm dhe popullor në pjesën tjetër;
- Mbrojtja & valorizimi i pasurisë historike & arkeologjike

Komponenti ekonomik i strategjisë e shikon Bashkinë Durrës si më poshtë:

- thjeshtësimi i procedurave të regjistrimit të ndërmarrjeve (one-stop-shop / dixhitalizimi / etc) dhe mbulimi i gjithë territorit me to;
- kontekst fiskal avantazhues & logjistike mbështetëse bashkëkohore sidomos në aksin Duranë, Shkozë, ZIPR dhe PI Rrashbull;
- ngritja e Qendrës të Mbrojtjes për NVM & promovimin e tyre (fokusuar në shitje, marketing, netëorking, shërbime administrative / financiare, etc)
- ngritja e strukturave pritëse speciale dhe procedurave fast-track për investitorët e mëdhenj.

Toka bujqesore ze rreth 70% te territorit te Bashkise se Re. Komponenti bujqesor i strategjise e shikon Bashkine Durres si me poshte:

- ruajtjen e fondit te tokes bujqesore nepermjet bllokimit te lejeve te ndertimit dhe regjistrimit;
- rritjen e efieneses se aktiviteve bujqesore, nepermjet rritjes se rendimenteve, specializimin ne kultura me vlere te larte, kompletimi i zinxhirit te vleres, etj;
- Krijimin e tregjeve & rrugëve lidhese per inkurajimin dhe mbeshtetjen e zinxhirit te vleres te produkteve bujqesore drejt aktiviteve me vlere te shtuar te larte

Durresi eshte shume i pasur me ujera: deti, rezervuaret, lumenjte, ujrat nentokesore, por vuan nga problemet e ruajtjes dhe perdorimit efficient. Strategjia 2015-2030 synon:

- mbrojtjen nga uji (vershimet / erozioni lumor & detar / ngritje e nivelit te detit & ujrave nen-tokesore;
- promovimi i turizmit gjate brigjeve ujore (det, lume & rezervuar);
- mbrojtja e ujrave nga ndotja;
- furnizimi i popullates me uje te pijshem

Bashkia Durres eshte ne kryqezim te akseve infrastrukturore evropiane te transportit dhe energjise. Strategjia per infrastrukturen synon:

- shnderrimin e Durresit ne nje nyje shkembimi moderne ku nderthuren akset infrastrukturore evropiane, rajonale dhe kombetare, nepermjet: i) promovimit & lobimit ne Qeveri, Rajon dhe BE, dhe ii) ndertimit te infrastruktures plotesuese / lidhese / mbeshtetese pergjate akseve dhe nyjeve evropiane;
- lidhja dhe sherbimi i territorit me infrastrukture bashkekohore
- ofrimin e nje infrastrukture moderne urbane per te gjithë qytetaret e Bashkise

Bashkia Durres eshte territori ku nderthuren projekte ne shkalle evropiane, kombetare dhe lokale:

- evropiane: TEN-T, Peci dhe projekte te tjera te Procesit te Berlinit
- kombetare: ZIPR, Porti i Durresit, Hekurudhat, etj
- lokale: rruget lokale, shkollat, shtepite e pleqve, mbetjet, etj

Bashkia Durres mund te kerkoje dhe te marre financime si më poshte:

- evropiane: nepermjet lobimit ne Qeveri, Keshillit Kombetar te Investimeve, Western Balkans Investment Framework, IFI;
- kombetare: Fondi i Zhvillimit te Rajoneve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, etj
- lokale: buxheti i Bashkise
- IPA CBC, programe te tjera BE, Donatoret Bilaterale (SDC, ADA, USAID, etc)
- partneriteti me privatet (koncesione, PPP)

Ne perfundim Bashkia Durres duhet të:

- projektoje te ardhmen e Durresit ne nivel rajoni evropian. Kontakti direkt me BE dhe me Komitetin Evropian te Rajoneve jane prioritet;
- ndertoje strukturat, procedurat dhe ekipet perkatese qe do te mundesojne vendosjen e Durresit ne agenden e zhvillimeve & projekteve kombetare dhe nderkombetare qe ne dizajnimin e tyre;

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Plani i Përgjithshëm Kombëtar impakton dhe orienton zhvillimet në Bashkinë Durrës sipas fushave të paracaktuara si më poshtë:

1. **Zhvillimi Ekonomik:** në funksion të rajonit Ekonomik Tiranë Durrës i profilizuar në Shërbime, Tregëti (shkëmbim & perpunim), Turizëm, Bujqësi, dhe si platformë shkëmbimi ndërkombëtare dhe kombëtare në Transport, dhe Energji e kompletuar me shërbimet mbështetëse përkatëse;
2. **Turizmi:** mbështet ndërlidhjen e sektorëve të shërbimeve përkatëse bazuar në elementet natyrore, historikë, kulturore, etj dhe shërbimet mbështetëse;
3. **Bujqësia:** synon ruajtjen e fondit të tokës bujqësore me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban, dhe ndërtimin e zinxhirit të vlerës mes sektoreve të bujqësisë, turizmit, transportit dhe energjisë;
4. **Transporti:** orientohet nga zhvillimi i mobilitetit dhe optimizimi i lëvizshmërisë midis komuniteteve; dhe mes vendbanimeve dhe tregjeve (të punës / të shërbimeve / bujqësore/ etj) me qëllim përmirësimin e ndërlidhjes midis bizneseve, individëve dhe shërbimeve publike. Në këtë kuader, për Bashkinë Durrës është shumë i rëndësishëm avancimi i Projekteve Strategjike kombëtare infrastrukturore rrugore / portuale / hekurudhore që mundësojnë flukset kombëtare & ndërkombëtare, si:
 - i) Projektimi dhe Zhvillimi i Korridorit Blu (rruge bregdetare turistike me impakt të ulët mjedisor që lidh lokalitetet e bregdetit: Velipojë – Shëngjin – Patok – Durrës – Divjake – Seman – Vlorë – Dhermi – Sarandë – Butrint);
 - ii) Korridori VIII si rrugë përsosore e transportit të mallrave (lidhja me të shkurterë e detit Mesdhe me Detin e Zi; Durrës – Varna/ Durrës – Stamboll) dhe Via Egnatia si rrugë historike me rëndësi turistike.
 - iii) Rruga e Kombit (Durrës – Kukës – Prishtinë – Nish) si një nga korridoret me ndikim më të madh në rajon, për shkak të lidhjes përmes Prishtinës me Korridorin X dhe Serbinë.
 - iv) Zhvillimi i Portit të Durrësit (mallra – turistik) si porti kryesor në Shqipëri dhe pike nisje e autostradave detare nepermjet investimeve për rritjen e kapacitetit të tij dhe të funksioneve komplementare.
 - v) Zhvillimi & Profilizimi i Portit industrial të Porto Romanos si port mallrash, dhe turistik; lidhja e tij me infrastrukturën adeguatë dhe plotësimi me funksione komplementare.
 - vi) Ristrukturimi i sistemit hekurudhor në akset kryesore: a) Tiranë – Rinas (Aeroport) – Durrës; Durrës – Vlorë; iii) Durrës – Hani Hotit (Montenegro Border); iv) Durrës – Lin, Pogradec (kufiri Maqedoni); dhe b) zhvillimi i Durrësit si një prej 10 stacioneve ndërkombëtare intermodale, për përmbushjen e nevojave tranzitore të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteteve të transportit me vendet e tjera.
5. **Energjia:** nepermjet krijimit të një tregu të brendshëm energjiek (mbështetur në parimin e konkurrenshëmërisë, furnizimit të sigurt, qëndrueshmërisë, dhe konsolidimit me infrastrukturë të përshtatshme), ku Porto Romano është identifikuar si një ndër dy portet kryesore në vend.

6. **Zhvillimi urban:** Ne Bashkinë Durrës PPK perkthehet ne përmirësimin e mjedisit urban me anë të rigjenerimit, konsolidimit, sigurimin e integritetit fizik dhe territorial te peisazhit historik, kulturor, natyror dhe urban te zones. PPK nenvizon promovimin e Sukthit si pol te dyte urban ne kete bashki;
7. **Zhvillimi natyror-mjedisor:** PPK ne Durrës synon ruajtjen e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndikon ne Bashkinë Durrës nepermjet integritit te sistemeve aktuale natyrore, krijimin e rrjeteve të parqeve, dhe ofrimin e nje cilesie me te mire jetese dhe biznesi. PPK cileson urgjente menaxhimin e mbetjeve urbane drejt nje cikli te mbyllur. Masa e propozuara jane krijimi i rrjetit vendor te bicikletave ne zonat natyrore me vlera peisazhistike natyrore dhe zonat e trashegimise historikedhe kulturore; ruajtja dhe shtimi i zonave te mbrojtura natyrore; krijimi dhe konsolidimi i korridoreve lidhese natyrore pergjate luginave ujore, ne lidhje te qendrueshme me zonat e mbrojtura; etj.

Në strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Durrës 2015-2030 është përcaktuar edhe vizioni i Bashkisë, si dhe politikat strategjike zhvillimore si më poshtë

VIZIONI

Bashkia Durrës synon te behet: (i) platforme shkembimi e kompletuar me logjistike mbeshtetese per flukset kombetare dhe nderkombetare te mallrave, energjise dhe personave, (ii) qender zhvillimi ekonomik terheqese per investimet e huaja, dhe (iii) qender urbane policentrike e pjesshme qe ofron sherbime cilesore ndaj qytetareve te saj, dhe vizitoreve.

Realizimi i vizionit të Bashkisë Durrës 2030 do te kryhet përmes zbatimit të tre politikave strategjike zhvillimore, ku secila prej tyre detajohet ne objektiva, masa zbatimi, programe dhe projekte.

Politika Strategjike I: Durrësi, platforme shkembimesh & nyje logjistike ne sherbim te rajonit te Ballkanit dhe Europes Jug-Lindore

Durrësi do te rikthehet si nyje e rendesishme lidhese ne rajon, dhe platforme shkembimi qe ofron sherbime logjistike te nivelit evropian, nepermjet zhvillimeve kombetare, rajonale dhe evropiane nepermjet:

- promovimit te lidhjes detare të Durrësit me Evropën dhe rajonin e Mesdheut, nepermjet vendosjes se territorit ne Axhenden e Konektivitetit te BE / Procesin e Berlinit (intensifikimit te qarkullimit te mallrave, sherbimeve, energjise nga Porto Romano dhe te njerezve nga porti i Durrësit, etc);
- pozicionimit të Durrësit si pjesë e sistemit te transportit inter-rajonale nëpërmjet planifikimit të projekteve transballkanike, si dhe duke favorizuar zhvillimin e portit si hyrja kryesore e Korridor VIII;
- shfrytëzimit te sinergjisë zhvillimore qe sjell ekzistenca ne territor e dy porteve (Durrës dhe Porto- Romano), e zones Ekonomike Spitalle, zones industrial Rrashbull, Parkut Logjistik te Shkozetit, qasjes ne Durana, lidhjes me hekurudhe dhe qasjes ne transportin ajror nga Rinasi.

Bashkia e Durrësit do të orientojë politikat e saj në arritjen dhe mbështetjen e këtyre projekteve madhore kombëtare, rajonale dhe evropiane duke ndërhyrë në dy mënyra:

- Në procesin e planifikimit: Bashkia e Durrësit lobon dhe advokon prane qeverise qendrore, partnereve rajonale jashte Shqiperise, EBIF, Komisionit Evropian dhe Institucioneve Financiare Nderkombetare për realizimin e projekteve (planifikim, financim dhe zbatim);

- Në procesin e zhvillimit: zhvillon planifikimin urban të infrastruktures lidhese dhe mbështetese në mbështetje të projekteve të sipërpërmendur.

Politika Strategjike II: Durrësi atraktiv për investitorët strategjike & motor zhvillimi ekonomik në Shqipëri

Bashkia Durrës mirepret, lehtëson dhe orienton investitorët e huaj dhe vendas në përputhje me vizionin e saj për zhvillim.

Investimet e pritshme në Bashkinë Durrës janë kryesisht strategjike me impakt në ekonominë kombëtare dhe rajonale. Në mbështetje të këtyre investimeve Bashkia Durrës bashkepunon ngushte me qeverinë qendrore, me Agjencinë e Promovimit të Investimeve dhe me partnere të tjere institucionale dhe financiare vendore, rajonale dhe evropiane.

Investimet strategjike që do të orientohen kryesisht në zonën ekonomike Spitalle dhe në Porto Romano, në sektorët industriale të energjisë, transportit, manifaktures, do të mbështeten në bashkepunim me qeverinë qendrore.

Investimet e fokusuar në nivel lokal në mikro-ndërmarrje me impakt të lartë ekonomik & social, ku përfshihen sektorët e turizmit dhe bujqësisë, do të mbështeten kryesisht përmes mekanizmave lokale.

Politika Strategjike III: Durrësi për qytetaret

Bashkia Durrës do të ofroj shërbime eficiente, cilësore dhe gjithë-përfshirëse të fokusuar tek banorët. Bashkia Durrës synon të rrisë cilësinë e jetesë së banorëve, dhe të redukttojë pabarazitë si brenda Bashkisë, ashtu dhe mes Bashkisë Durrës dhe rajoneve të tjerë ngjashme Ballkanike dhe të Europës Jug-Lindore. Bashkia Durrës do të ofrojë për banorët e saj: jetesë cilësore; mundësi zgjedhjeje për cilësi të lartë në shkollim; orientim profesional për punësim të krenar; akses të kollajtë në shërbime administrative lokale dhe mundësi për të ndikuar në politikat zhvillimore të bashkisë; lehtësim për mobilitet lokal dhe rajonal; përmirësim të infrastrukurës rrugore, portuale, hekurudhore dhe ujore.

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS)

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsye dhe Përfituesit

3.2.1 Zhvillimi ekonomik në nivel kombëtar

Projektet e parashikuara në nivel qendror që impaktojnë politikën strategjike : Durrësi si platformë shkëmbimesh dhe nyje logjistike në shërbim të rajonit të Ballkanit dhe Europës Juglindore, janë:

- Projekte strategjike infrastrukturore ndërkombëtare (Durrësi si nyje kyce) deri në 2030, të detajuara si më poshtë:
 - Korridori VIII si rrugë përsosë e transportit të mallrave (lidhja me e shkurter e detit Mesdhe me Detin e Zi; Durrës Varna/ Durrës Stamboll) dhe Via Egnatia si rrugë historike me rendesi turistike
 - Rruga e Kombit (Durrës – Kukës – Prishtinë – Nish) si një nga korridoret me ndikim më të madh në rajon, për shkak të lidhjes përmes Prishtinës me Korridorin X dhe Serbinë;
 - Durrës ---- Hani Hotit (Kufiri i Malit të Zi);
 - Durrës – Lin, Pogradec (Kufiri i Maqedonisë);

- Ristrukturimi i linjave hekurudhore që lidhin qendrat e përpunimit dhe nxjerrjes së mieraletve me portin e Durrësit.
- Projekte infrastrukturore zhvillimore me rendesi kombetare (Durrësi si nyje kyce) deri në 2030, si më poshtë:
 - Projektimi dhe Zhvillimi i Korridorit Blu (rruge bregdetare turistike me impakt të ulët mjedisor që lidh lokalitetet e bregdetit: Velipojë – Shëngjin – Patok – Durrës – Divjake – Seman – Vlorë – Dhermi – Sarandë – Butrint);
 - Zhvillimi i Portit të Durrësit (mallra – turistik) si një nga 4 portet kryesore në Shqipëri, pike nisje të korridoreve detare;
 - Investime në rritje të kapacitetit dhe funksioneve komplementare të portit Durrës si porta perendimore qendrore që lidh rruget kombetare të korridorit VIII me perendimin;
 - Investime në rritje për Portin industrial të Porto Romanos – Profilizimi si port mallrash, dhe turistik – me qëllim lidhjen e tij me infrastrukturën e nevojshme për plotësimin me funksione komplementare;
 - Ristrukturimi i sistemit hekurudhor në akset kryesore: a) Tiranë – Rinas (Airport)– Durrës; b) Durrës – Vlorë;
 - Ndërtimi i Portit të Jahteve së bashku me Marinën

Keto zhvillimi kombëtar dhe nderkombëtar e prekin dhe kushtëzohen strategjitë e zhvillimit të territorit të Bashkisë Durrës. Mbi keto kushtëzime, Bashkia ndërtonte politikat e saj të cilat përkthehen në tre objektiva. Për secilin prej tyre Bashkia Durrës do të ndërmarrë hapat si më poshtë:

3.2.2 Zhvillimi ekonomik në nivel lokal

- Rehabilitim, përmirësimi me infrastrukturë rrugore për zonat që ofrojnë shërbime bujqësore në treg.
- Rehabilitimi i kanaleve të vaditjes dhe kullimit.
- Krijimi i itinerareve turistike në të cilin do të përfshihet dhe oferta e agroturizimit/ ecoturizmit
- Orientimi i turizmit në krijimin e një “Brandit turistik” & krijimi i markës rajonale të produkteve “Made in Durana”.
- Zhvillimi i itinerarit të bicikletave duke e ndërthurur me itinerarin e turizmit rural, agroturistik në kodrat e NJA Ishëm
- Nxitja e bizneseve të lidhura me agrobiznesin në Manzhë dhe Ishëm
- Orientimi i investitorëve të huaj dhe vendas për zhvillim biznesi në zonat:
 - Ishëm – gjiri i Lalzit – turizëm familjar (det & rrëzë)
 - Ishëm – pjesa kodrinore – agroturizëm – ekoturizëm ngjitje në mal/ciklizëm/kamping/kalërim/ecje
 - Sukth- agroturizëm (Ushqime Bio)
- Hartimi i një programi për përmirësimin e transportit publik fokusuar në vendosjen e rregullave të sakta dhe strikte për itineraret dhe oraret, cilësinë e shërbimit, etj;
- Krijimi i unazave të brendshme që lidhin NJA-të
- Rehabilitimi i zonave të banuara
- Përmirësimi i infrastrukturës të sistemit të ujit të pishëm, ujërave të ndotura, ujërave të bardha në të gjithë territorin e bashkisë
- Krijimi i një sistemi vetëm për linjat e bicikletave brenda zonave të banuara që lidhen me zonat natyrore
- Krijimi i një sistemi për organizimin e hapësirave të destinuara për parkim automjesh
- Përmirësimi i rrjetit elektrik dhe i ndricimit rrugor në të gjithë bashkinë

BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË DURRËS 2026-2028

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Durrës gjatë periudhës 2026-2028, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse.

Sipas Kalendarit të Dëgjësave Publike të hartuar për Programin Buxhetor Afatmesëm PBA 2026-2028, u organizuan 24 Dëgjesa Publike në të gjitha Nj/Administrative të Bashkisë Durrës. Në këto 24 Dëgjesa Publike, morën pjesë rreth 242 pjesëmarrës, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e Bashkisë.

Gjatë organizimit të këtyre Dëgjësave Publike, u diskutua për investimet, shërbimet dhe projektet sipas programeve që ka kryer Bashkia si dhe rekomandimet dhe sugjerimet e dala nga pjesëmarrësit. Numri në total i rekomandimeve të dala nga këto Dëgjesa Publike është 40 rekomandime.

Projektet kryesore të investimeve me fondet e Bashkisë për vitet 2026-2028 janë:

- ✓ Përfundimi i rikonstruksionit të Pallatit të Kulturës “Aleksandër Moisiu” në vitin 2026
- ✓ Rikonstruksion i Pallatit të Sportit “Ramazan Njala”
- ✓ Ndërtimi i ri i godinave të shkollave: “Vasil Ziu” dhe “Nënë Terza”, shkolla 9 vjecare Bishtkamëz, gjimnazi “Gjergj Kastrioti”
- ✓ Brenda vitit 2026 përfundojnë godinat e reja të rindërtuara të shkollave: “Met Hasa”, Shkolla 9 vjecare e Vadardhës, gjimnazi i Vadardhës.
- ✓ Përfundimi i rikonstruksionit të pallateve të dëmtuara nga tërmeti.
- ✓ Vazhdojmë me rikonstruksione të rrugëve në qytet dhe Njësitë Administrative, rehabilitime kuatallash, rehabilitim të rrjetit ndricues, si dhe shtim të sipërfaqeve të gjelbërta.

TABELA 1. INFORMACION BAZË MBI BASHKINË DURRËS

		Të Përgjithshme	2021	2022	2023	2024	2025
1	Numri i Njësive Administrative	11	0	0	0	0	0
2	Numri i Fshatrave	39	0	0	0	0	0
3	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	338	0	0	0	0	0
3.1	Qyteti	49	0	0	0	0	0
3.2	Njësitë Administrative	289	0	0	0	0	0
4	Sipërfaqja e NJVQV	341.76	0	0	0	0	0
4.1	Zonë Urbane	63.75	0	0	0	0	0
4.2	Tokë Bujqësore	214.06	0	0	0	0	0
4.3	Kullota	6.14	0	0	0	0	0
4.4	Pyje	57.81	0	0	0	0	0
4.5	Të tjera	0	0	0	0	0	0
5	Popullsia e NJVQV	0	334,448	338,220	341,425	344,245	344,245
5.1	Qyteti	0	229,472	231,524	233,668	235,322	235,322
5.2	Njësitë Administrative	0	104,976	106,696	107,757	108,923	108,923
6	Mosha Mesatare e Popullsisë	0	37	38	38	43	43
7	Numri i Lindjeve	0	1,855	1,529	1,377	1,369	1,369
8	Numri i Vdekjeve	0	1,827	1,283	1,066	1,079	1,079
9	Numri i Bizneseve Aktive	0	13,197	14,100	13,535	13,394	13,394
10	Numri i Familjeve	0	104,709	106,797	108,809	110,448	110,448
10.1	Qyteti	0	75,732	77,032	78,452	79,546	79,546
10.2	Njësitë Administrative	0	28,977	29,765	30,357	30,902	30,902
11	Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Plotë	0	1,757	1,783	1,811	1,879	1,944
11.1	Administrata e NJVQV	0	437	437	437	454	444
11.2	Njësitë Shpenzuese	0	1,320	1,346	1,374	1,425	1,500
12	Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Pjesëshme	0	30	65	45	45	45
12.1	Administrata e NJVQV	0	0	5	5	5	5
12.2	Njësitë Shpenzuese	0	30	60	40	40	40
13	Numri i Programeve Buxhetore	0	36	36	20	22	22

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Durrës në vitet 2026-2028

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Durrës për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

TABELA 2. TË ARDHURAT E BASHKISË SIPAS BURIMIT

		2023	2024	2025	2025	2025	2026	2027	2028
	Burimet Buxhetore (në 000/lek)	Fakti	Fakti	Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Fakti 11 mujor	Plani	Plani	Plani
1	Të ardhura nga burimet e veta	1,539,680	1,973,646	2,278,771	2,278,771		2,877,820	2,886,205	2,860,011
2	Transferta nga buxheti qendror	1,895,881	2,152,067	2,340,426	2,340,426		2,567,954	2,652,920	2,742,791
3	Te ardhura nga taksat e ndara	310,670	330,062	380,550	380,550		407,050	415,050	420,050
4	Grante dhe transfertat të tjera	1,220	0	0	0		0	0	0
5	Huamarrja	0	0	0	0		0	0	0
6	Trashegimi nga viti i kaluar	664,877	865,182	450,000	1,494,179		1,000,000	900,000	900,000
		4,412,328	5,320,956	5,449,747	6,493,926		6,852,824	6,854,175	6,922,861

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Durrës

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

Të ardhura nga burimet e veta, janë të gjitha të ardhurat që krijohen dhe administrohen në nivel vendor, nën autoritetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi. Këto të ardhura vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore, planifikimi i të cilave është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Durrës, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

		Fakt 2023	Fakt 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	1,539,680	1,973,645	2,278,771	2,877,820	2,886,205	2,910,014
1.1	Taksa e pasurisë së paluajtshme	331,375	515,238	668,000	689,000	703,100	708,200
1.2	Taksa e ndik. Në infrastrukture nga ndërt. E reja	369,440	235,868	500,000	800,000	800,000	800,000
1.3	Taksa të tjera vendore	115,832	219,237	181,000	292,500	260,000	262,000
1.4	Tarifa vendore	594,721	849,191	807,970	946,625	962,380	971,049
1.5	Të ardhura nga asetet dhe aktiviteti ekonomik	35,784	40,617	41,801	41,281	41,281	41,141
1.6	Të tjera administrative	92,528	113,495	80,000	108,413	119,443	127,624
	<i>% e të ardhurave të veta kundrejt totalit të të ardhurave</i>	<i>35%</i>	<i>37%</i>	<i>42%</i>	<i>42%</i>	<i>42%</i>	<i>41%</i>

TABELA 3: TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA 2023-2028 NË 000 LEKË

Për vitin 2026, planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta është planifikuar me rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2025, në përputhje me pritshmëritë për menaxhim më të mirë fiskal, zgjerim të bazës së taksapaguesve dhe masa të shtuara për forcimin e administrimit të të ardhurave. Sipas tabelës së planifikimit, të ardhurat nga burimet e veta parashikohen të arrijnë në 2,877,820 mijë lekë në vitin 2026, nga 2,278,771 mijë lekë në vitin 2025, pra një rritje prej 599,049 mijë lekë (rreth 26% më shumë). Pesha e të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave mbetet 42%, e njëjtë me vitin 2025, por me një bazë monetare dukshëm më të lartë.

Bashkia Durrës ka aktualisht 14,440 subjekte aktive, nga të cilat 3,402 biznese të mëdha dhe 11,038 biznese të vogla. Evidentohet trend rritës, veçanërisht në kategoritë: shërbime, tregti, bar-restorante, hotele/motele, si dhe aktivitetet e dhënies me qira, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e bazës së taksave dhe tarifave vendore.

Në planifikimin 2026 janë marrë në konsideratë masa të shtuara për forcimin e kontrollit të detyrimeve, rritjen e eficiencës së arkëtimit, intensifikimin e punës për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura. Këto masa pritet të përkthehen në rritje të arkëtimit neto gjatë vitit 2026.

Rritja e numrit të vizitorëve të huaj në sezonin turistik, do të reflektohet edhe në rritje të të ardhurave nga Taksa e Fjetjes në Hotel, si dhe do të ketë efekt zinxhir në rritjen e të ardhurave nga taksa/tarifa të tjera të lidhura me aktivitetin e shërbimeve, tregtisë dhe strukturave akomoduese.

Rritja më e madhe që shpjegon zgjerimin e Planit 2026 lidhet me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Ky zë parashikohet të rritet nga 500,000 mijë lekë në Planin 2025 në 800,000 mijë lekë në Planin 2026, pra 300,000 mijë lekë më shumë.


Kjo rritje sinjalizon:

- ✓ pritshmëri më të larta për zhvillim urban dhe leje ndërtimi,
- ✓ reflektim të projekteve të reja ndërtimore dhe ritmit të zhvillimit,
- ✓ qasje më optimiste, por të strukturuar në planifikimin afatmesëm.

Një zë tjetër me ndikim të rëndësishëm është rritja e tarifave vendore, të cilat parashikohen të rriten nga 807,970 mijë lekë në Planin 2025 në 946,625 mijë lekë në Planin 2026, pra 138,655 mijë lekë më shumë.


Kjo rritje vjen kryesisht si rezultat i:

- ✓ planifikimit me më shumë të ardhura nga tarifat për shërbimet administrative të bashkisë,
- ✓ përmirësimit të mbledhjes dhe formalizimit të pagesave për shërbime,
- ✓ rritjes së kërkesës për shërbime.



Grafik 1: Ndryshimi i të ardhurave nga burimet e veta, vitet 2024-2028

Peshë të rëndësishme tek të ardhurat nga burimet e veta kanë të ardhurat nga taksat vendore, e më pas të ardhurat nga tarifat.



Grafik 2: Struktura e të ardhurave nga burimet e veta, vitet 2024-2028

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

		Fakt 2023	Fakt 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
	Të Ardhura nga Taksat Lokale	816,647	965,521	1,309,000	1,691,500	1,713,100	1,720,200
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	4,426	-	-	-	-	-
2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	331,375	515,238	668,000	689,000	703,100	708,200
3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	65,391	152,921	110,000	170,000	175,000	177,000
4	Taksa e ndik. në infrastrukturë nga ndërt.	369,440	235,868	500,000	800,000	800,000	800,000
5	Taksa e tabelës	18,470	27,233	31,000	32,500	35,000	35,000
6	Taksa e përkohëshme për arsimin	27,545	34,261	0	0	0	0


TABELA 4: TË ARDHURAT NGA TAKSAT LOKALE 2023-2028 NË 000 LEKË

Pjesë e rëndësishme tek të ardhurat nga taksat janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme dhe Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme planifikohet në rritje si rezultat i mbledhjes më të mirë të kësaj takse nga taksapagues biznese dhe taksapagues familjare, rritja e konsiderueshme e numrit të bizneseve aktiv do të sjellë rritjen e të ardhurave të kësaj takse gjithashtu janë marrë masa për mbledhjen më të mirë të taksave nga taksapagues familjarë nëpërmjet agjentit tatimor UKD, që do të sjellë rritjen e të ardhurave me regjistrimin e 71'000 taksapagues familjarë në sistemin e agjentit tatimor

Duke qënë se në vitin 2025 janë mbledhur afërsisht 20% të detyrimeve të prapambetura të bizneseve nga totali i të ardhurave për 2025, planifikohet që dhe për vitin 2026 të vazhdohet me të njejta masa shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu ka marrë masa për krijimin e një regjistri për Taksën mbi tokën bujqësore dhe taksën e truallit nga taksapagues familjarë. Për vitin 2026 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është planifikuar me një rritje prej 3% dhe Taksa e Ndikimit në infrastrukturë planifikohet me një rritje prej 60% dhe nga Taksa e tjera planifikohen 62% më shumë të ardhura krahasuar me planin 2025, ndërsa pesha e këtyre taksave në totalin e të ardhurave nga burimet e veta është 24% nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme dhe 28% nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 10% nga taksa të tjera vendore.

Duke ju referuar rëndësisë që ka kjo taksë po punohet në plotësimin e regjistrit dhe mbledhjen e plotë të detyrimeve të kësaj takse.



Grafik 3: Ndryshimet e të ardhurave nga taksat vendore, viti 2024-2028

Të ardhurat nga taksat në vitin 2026, parashikohen të jenë 3% më shumë se viti 2025. Kjo rritje vjen si rrjedhojë të pritshmërive, rritjes së të ardhurave, rritjes së numrit të bizneseve dhe abonentëve familjarë, rritjes së numrit të turistëve të shprehura dhe më lart dhe rritjes së mbledhjes së të ardhurave nga debitorët.

A1.1 Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël

Për vitet 2025-2027 nuk janë planifikuar të ardhura nga kjo taksë, mbështetur në relacionin e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës ku i referohet vendimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për Tatimin e Thjeshtuar bazuar në Ligjin 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", është ndryshuar me efekt nga 01 Janar 2021 deri në vitin 2029 me Ligjin Nr.106/2020 botuar në Fletoren Zyrtare nr.154, datë 26.02.2020, ku neni 28, pika 1 gërma a) përcakton se për tatimpaguesit me të ardhura 0 deri në 14 000 000 lekë në vit shkalla e tatimit do të jetë 0%. Në këtë fashë përfshihen edhe tatimpaguesit të cilët janë subjekte të Tatim Fitimit të Thjeshtuar (nga 0 deri 8 milion). Për këtë arsye nuk mund të bëjmë një parashikim të të ardhurave nga kjo taksë.

A1.2 Të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihet: a) taksa mbi ndërtesën, b) taksa mbi tokën bujqësore dhe c) taksa mbi truallin

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Duke u mbështetur në Vendimin nr. 132, datë 7.3.2018 Për Metodologjinë për Përcaktimin e Vlerës së Taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme “Ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës, tregohet metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”. Çmimit vlerësues mesatar i referuar për Bashkinë Durrës për ndërtesat është **67,500 lekë** për metër katror, ky cmim ka ndryshuar bazuar në Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr.1052, datë 02.12.2024, “Për Miratimin e mesatares së çmimeve të shitjes së banesave në treg, sipas zonave kadastrale për njësitë e vetëqeverisjes vendore” dhe për Bashkinë Durrës cmimi për ndërtesat është 71,157 lekë për metër katror.

Gjithashtu pritet që gjatë vitit 2016 të ndryshojë Vendimi nr. 132, datë 7.3.2018 Për Metodologjinë për Përcaktimin e Vlerës së Taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme “Ndërtesa”..... Bashkia e Durrësit parashikohet të ndahet në 13 zona dhe cdo zonë do të ketë cmimin vlerësues mesatar. Kjo do të ndikojë pozitivisht në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë.

Nr	LLOJET E TE ARDHURAVE	2023	2024	2025	2026	2027	2028
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	331,375	515,238	668,000	689,000	703,100	708,200
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	294,387	444,464	568,000	574,000	586,000	589,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	9,030	15,638	47,000	48,000	49,000	50,000
1.1.3	Taksa mbi truallin	27,958	55,136	53,000	67,000	68,100	69,200

TABELA 5: TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME, PËR VITET 2023-2028 NË (000 LEKË)

Peshën kryesore në të ardhurat nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme e ka taksa mbi ndërtesat e biznesit dhe familjeve. Me rritjen e numrit të bizneseve, të abonentëve familjarë dhe planifikimit të mbledhjes më të mirë të borxhit si planifikohet që për vitin 2026 kjo taksë të rritet në vlerën 21,000 mijë lekë më shumë ose 3% më shumë. Aktualisht planifikimi i kësaj takse i referohet rritjes së sipërfaqes totale të ndërtesave sipas kategorive përkatëse, mbledhjes së detyrimeve të prapambetura dhe trendit të rritjes gjatë viteve si dhe ndryshimit që do të vijë nga cmimi i ri vlerësues. Për mbledhjen e taksës së tokës bujqësore janë marrë masa për regjistrimin e të gjithë fermerëve dhe familjarëve të cilet do të paguajnë taksën për tokën bujqësore, gjithashtu po punohet për mbledhjen e të dhënave nga taksa e truallit për taksapaguesit familjarë.

A1.3 Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Bashkia ka planifikuar rritje të të ardhurave për vitin 2026 për shkak të pritshmërive si rezultat i rritjes së numrit të turistëve dhe numrit të bizneseve të kësaj kategorie. Ndryshimet e pritshme të të ardhurave janë rezultat i rritjes së numrit të hoteleve dhe të shtretërve në hotele ardhur kjo si rrjedhojë e rritjes së turizmit në vend, rritjen e numrit të bizneseve të kësaj kategorie dhe rritjes së mbledhjes së detyrimeve të prapambetura duke sjellë kështu rritjen e të ardhurave.

Në bashkinë Durrës operojnë afërsisht 288 hotele me një kapacitet prej 7500 dhoma dhe 16484 numër shtretësh. Të ardhurat nga kjo taksë planifikohen të rriten me 69% ose 60'000 mijë lekë më shumë në krahasim me vitin e kaluar 2025 .

Nr	LLOJET E TE ARDHURAVE	2023	2024	2025	2026	2027	2028
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	65,391	152,921	110,000	170,000	175,000	177,000

TABELA 6: TË ARDHURAT NGA TAKSA E FJETJES NË HOTEL, PËR VITET 2023-2028 NË (000 LEKË)

A1.4 Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Durrës. Sipas ligjit 68/2017, neni 12, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja, kryesisht, duhet të përdoret për financimin e investimeve publike vendore.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Bazuar në ligjin nr. 9632 dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 107/2015 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 39 dhe neni 46 niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja jopublike është parashikuar si më poshtë:

Në vitin 2026 parashikohet një rritje të të ardhurave nga kjo taksë, rreth 60%. Kjo rritje është planifikuar duke u mbështetur tek Plani i Ri Vendor me Vendim Nr.4 datë 27.07.2022 i Këshillit Kombëtar i Territorit , rritja e kërkesave për leje dhe rritja e të ardhurave referuar vitit të kaluar. Niveli i rritjes është më i madh në krahasim me vitin 2025 duke qënë se numri i aplikimeve për leje janë rritur, objektet janë të mëdha dhe priten pagesat e detyrimeve të lindura nga këto leje.

Rritja prej 60% e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja vjen dhe si rezultat i ndryshimit të Vendimit 325, datë 29.05.2024 për Kontributin e sektorit privat për krijimin e fondit publik të banesave sociale ku kalimi i sipërfaqes ndërtimore është e dhënë në vlerë leku në bazë të se cilës është bërë dhe planifikimi në vlerë monetare të këtij zëri të përfshirë tek taksa e ndikimit në infrastrukturë.

1.4 Tarifat Vendore


Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

- a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

		2023	2024	2025	2026	2027	2028
1.4	TARIFA VENDORE	576,039	846,528	807,970	946,624	962,380	971,050
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	241,469	371,841	391,000	401,000	411,000	415,000
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	122,322	148,012	90,000	121,000	121,000	121,000
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	65,104	104,088	119,000	134,500	136,500	138,500
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	57,436	89,744	99,000	116,500	118,000	120,000

1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	34,401	45,551	12,400	57,154	57,359	57,425
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	44,748	50,771	45,270	51,568	53,138	53,252
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	2,099	1,497	1,300	2,602	2,733	2,870
1.4.11	Tarifa e parkimit	8,460	35,024	50,000	62,300	62,650	63,003

Tabela : Të ardhurat nga tarifat vendore 2023-2028 në 000/ lekë



Grafiku 4: Të ardhurat nga tarifat vendore 2024-2028 në lekë

Peshën më të madhe në grupin e të ardhurave nga tarifat e zënë të ardhurat nga tarifa për menaxhimin e mbetjeve me 42%. Kjo tarifë duke filluar nga viti 2022 është për taksapagues familjarë : në qytet 3500 lekë /vit dhe në Njësitë Administrative 1500 lekë/vit. Niveli i tarifës për biznesin është sipas kategorive të biznesit duke respektuar parimin “ndotësi pagan”. Kjo tarifë së bashku me tarifën e ndriçimit dhe gjelbërimit për vitin 2026 janë planifikuar me rritje si rezultat i rritjes së numrit të bizneseve, mirëmenaxhimit të mbledhjes së të ardhurave vjetore, mbledhjes së të ardhurave nga debitorët dhe rritjes së mbledhjes së të ardhurave nga taksapagues familjarë me anë të agjentit tatimor UKD. Tarifa e Pastrimit është planifikuar me 3% rritje në krahasim me vitin 2025, Tarifa e Gjelbërimit me 18% rritje më shumë në krahasim me vitin 2025, Tarifa e Ndriçimit me 13% më shumë se planifikimi i vitit 2025 këto dy tarifa janë planifikuar më shumë pasi është bërë një përlogaritje më e saktë e të ardhurave që mund të realizohen nga këto dy tarifa për taksapaguesit familjarë duke ju referuar numrit të taksapaguesëve të regjistruar në sistemin e UKD në krahasim më 48’000 taksapagues që kanë qënë më parë. Tarifa e pastrimit nuk është rritur me të njëjtat nivele si rezultat i përjashtimeve që i janë bërë pensionistëve dhe grupeve në nevojë.

Ndërsa Tarifa e Parkimit është planifikuar me 25% rritje në krahasim me vitin 2025 duke qënë se planifikohet rritja e vendparkimeve publike me pagesë. Taksa e Zënies së Hapësirës Publike është tarifa që zë vendin e tretë në peshën më të madhe të realizimit të të ardhurave dhe për vitin 2026 kjo tarifë planifikohet të rritet me 34% si rezultat i rritjes së planifikimit të të ardhurave nga plazhet private dhe tarifa e zënies së hapësirës publike.

1.5 Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

		2023	2024	2025	2026	2027	2028
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	35,784	40,617	41,801	41,281	41,281	41,141

Tabela 8: Të ardhura nga asetet 2022-2027 në 000/ lekë

Të ardhura nga asetet dhe aktiviteti ekonomik është planifikuar me vlerë më pak në krahasim me planifikimit të vitit 2025 pasi nuk planifikohet rritje të ndërtesave në pronësi të bashkisë që mund të jepen me qera gjatë kësaj periudhe.

1.6 Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

	2023	2024	2025	2026	2027	2028
TË TJERA ADMINISTRATIVE	92,529	113,495	80,000	108,413	119,443	127,623

Tabela 9: Të ardhura të tjera 2023-2028 në 000/ lekë

Ndërsa të ardhurat e planifikuara nga kundravajtjet dhe gjobat do të rriten me 36% më shumë se viti 2025 si rrjedhojë e masave shtrënguese nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake.

3. Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.


D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 përqind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

Planifikimi i tyre është i bazuar në parashikimin që kanë sjellë agjentët që realizojnë arkëtimin e këtyre taksave.

		2023	2024	2025	2026	2027	2028
3	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	310,670	330,062	380,550	407,050	415,050	420,050
3.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë/pasuritë e paluajtshme	58,323	52,966	105,000	107,000	110,000	110,000
3.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	174,943	190,446	195,500	205,000	210,000	215,000
3.3	Taksa e rentës minerare	21	21	50	50	50	50
3.4	Taksa mbi të ardhurat personale	77,383	86,629	80,000	95,000	95,000	95,000

Tabela 10: Të ardhurat nga taksat e ndara 2023-2028, 000/lekë

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori është taksa vjetore e mjeteve të përdorura dhe taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për Pasurinë e Paluajtshme. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë/pasuritë e paluajtshme është planifikuar më shumë krahasuar me planin e viteve të kaluara si rezultat i planifikimit në rritje të aplikimeve në zyrat e ASHK, ndërsa Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është planifikuar në rritje si rezultat i rritjes së të ardhurave nga kjo taksë ardhur nga rritja e numrit të automjeteve të regjistruara.



Grafik 5: Ndryshimet e të ardhurave nga taksat e ndara, viti 2024-2028 në (000 lekë)

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së. Për vitet 2023-2028 janë sipas tabelës së mëposhtme:

	Burimet Buxhetore (në mijë lekë)	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	1,206,215	1,377,968	1,504,035	1,504,035	1,695,882	1,780,847	1,870,000

2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	1,181,176	1,211,509	1,379,231	1,379,231	1,505,831	1,590,796	1,680,000
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	25,039	73,172	124,804	124,804	190,051	190,051	190,051

4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferata e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së dhe janë si në tabelën e mëposhtme:

	Burimet Buxhetore (në mijë lekë)	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	689,665	774,098	836,391	841,599	872,072	872,072	872,072
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	23,666	24,376	25,108	25,108	25,861	25,861	25,861
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimesor	213,550	246,343	290,138	290,138	312,130	312,130	312,130
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	58,366	61,877	64,347	64,347	82,460	82,460	82,460
2.2.4	Arsimi parauniversitar	21,897	23,078	24,000	24,000	29,855	29,855	29,855
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	56,113	62,942	94,508	99,716	102,198	102,198	102,198
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	3,653	3,819	3,972	3,972	4,735	4,735	4,735
2.2.8	Rrugët	26,659	29,703	30,634	30,634	31,563	31,563	31,563
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	49,761	51,232	53,278	53,278	58,171	58,171	58,171
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	236,000	240,791	250,407	250,407	225,100	225,100	225,100
2.2.12	Të tjera	0	29,937	0	0	0	0	0

Në mënyrë të detajuar planifikimi i të ardhurave për vitet 2026-2028 jepet në raportin e dokumentit të PBA 2026-2028 : PBA 2 – Parashikimi i të ardhurave.

4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Durrës për periudhën 2026-2028

Shpenzimet për vitin 2026 krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2026 janë rritur 5.4 %. Peshën specifike më të madhe do e zënë shpenzimet kapitale dhe sipas viteve 2026,2027, 2028 janë përkatësisht : 44%, 44% dhe 45%. Më pas vijnë shpenzimet e personelit me peshë specifike respektive për vitet 2026-2028: 30%, 30%, 29% dhe të tretat janë shpenzimet e tjera korrente përkatësisht me 26% për secilin vit.

Shpenzimet e Bashkisë Durrës për periudhën 2023-2028, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme, përfshijnë shpenzimet totale të Bashkisë për funksionet e saj mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike.

Tabela : Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.(në mijë lekë)

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
------	----------------------	---------------	---------------	-------------------	-------------------	---------------	---------------	---------------

	Shpenzime Personeli (600-601)	1,469,624	1,641,642	1,986,847	2,015,073	2,031,917	2,031,917	2,031,917
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	1,260,254	1,406,497	1,706,705	1,726,955	1,745,040	1,745,040	1,745,040
601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	209,370	235,146	280,142	288,118	286,878	286,878	286,878
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,234,923	1,411,698	1,470,088	1,593,298	1,772,996	1,772,996	1,772,996
602	Mallra dhe shërbime të tjera	1,118,006	1,275,636	1,261,785	1,330,469	1,318,356	1,307,984	1,307,984
603	Subvencionet	0	0	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
604	Transferime korrente të brendshme	40,000	46,064	38,236	60,236	61,000	61,000	61,000
605	Transferimet korrente jashtë	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	76,917	89,998	87,067	93,260	83,589	93,961	93,961
609	Rezervat	0	0	53,000	79,332	280,051	280,051	280,051
651	Interesa për huamarrje të tjera të brendshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje të tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	831,182	773,398	1,992,812	2,890,764	3,047,911	3,049,262	3,117,911
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupezuara	24,756	9,616	17,994	36,518	70,000	0	0
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupezuara	806,426	763,783	1,974,818	2,854,245	2,977,911	3,049,262	3,117,911
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala për hua-dhënie dhe nen-huadhenie të brendshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	3,535,729	3,826,739	5,449,747	6,499,134	6,852,824	6,854,175	6,922,824

Për vitin 2026 shpenzimet do të financohen në masën % nga tranferrat e buxhetit qendror për financimin e funksioneve të Bashkisë (transferte të pakushtëzuar dhe tranferrat sektoriale) dhe % do të financohen nga taksat dhe tarifatat, përfshirë dhe ato të mbarturat nga viti kaluar.

Shpenzimet për vitin 2026 sipas burimit të financimit janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela : Shpenzimet për vitin 2025 sipas burimit të financimit (në mijë lekë)

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PLANI 2026	Nga transferta sektoriale	Nga transferta e pakushtëzuar	Nga ardhur
	Shpenzime Personeli (600-601)	2,031,918	564,857	1,075,689	391,372
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	1,745,040	484,622	922,821	337,597
601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	286,878	80,235	152,868	53,775
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	1,772,996	301,215	620,193	851,588
602	Mallra dhe shërbime të tjera	1,318,356	301,215	374,553	642,588
603	Subvencionet	30,000	0	0	30,000
604	Transferime korrente të brendshme	61,000	0	21,000	40,000
605	Transferimet korrente jashtë	0	0	0	0
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	83,589	0	34,589	49,000
609	Rezervat	280,051	0	190,051	90,000
651	Interesa për huamarrje të tjera të brendshme	0	0	0	0

1661	Të dala, huamarrje të tjera afatgjatë	0	0	0	
	Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)	3,047,911	6,000	0	3,041,911
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të grupuara	70,000	0	0	70,000
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të grupuara	2,977,911	6,000	0	2,971,911
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	
255	Të dala për hua-dhënie dhe nën-huadhënie të brendshme	0	0	0	
TOTALI		6,852,825	872,072	1,695,882	4,284,871
Ne përqindje			13	25	6

Sikurse shihet edhe nga tabela 63% e shpenzimeve për vitin 2026 do të financohen nga të ardhurat e Bashkise dhe 47% nga transfertat e buxhetit.

➤ **Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore)**

Ky grup shpenzimesh për vitet 2026-2028 zë përkatësisht: 30%, 30%, 29%, ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për vitet përkatëse. Shpenzimet e personelit për vitin 2026 parashikohen pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2025. Planifikimi i këtyre shpenzimeve është bazuar në nivelin aktual të pagave. Ndryshimet e politikave për rritjen e pagave do të reflektohen gjatë vitit dhe efekti financiar i tyre do të përballohet nga fondi i alokuar si transfertë e pakushtëzuar për rritjen e pagave. Për vitet 2026-2028 është planifikuar një shtesë punonjësish prej 5 vetash. Konkretisht do të ketë 8 punonjës shtesë në shërbimin zjarrfikës, 6 punonjës shtesë në sistemin e arsimit parauniversitar, 1 punonjës në cerdhe, 2 punonjës me kohë të pjesshme për Qendrën Rinore Multifunksionale dhe ndërkohë do të pakësohen 2 punonjës në Klubin e Shumësporteve, 1 punonjës në Qendrën Ditore të Moshuarve, 5 punonjës sezonal në Ndërmarrjen Komunale Plazh, 2 punonjës të projektit të arkivës dhe 2 punonjës mbështetës në arsimin e mesëm që kalojnë në arsimin bazë. Pra shtohen 13 pozicione të reja dhe pakësohen 8 pozicione.

- Numri total i punonjësve të Bashkisë së bashku me 11 njësitë shpenzuese në varësi të saj që financohen nga buxheti i Bashkisë për vitet 2026-2028 do të jetë 2002 veta dhe për cdo program buxhetor paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Numri punonjësve 2025-2028

EMËRTIMI I PROGRAMIT	2025	2026	2027	2028
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	291	289	289	289
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	80	80	80	80
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	56	64	64	64
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik	-	-	-	-
04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe	-	-	-	-
04240 - Menaxhimi i ujërave dhe kullimit	26	30	30	30
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	3	3	3	3
04520 - Rrjeti Rrugor	83	78	78	78
04570 - Transporti Publik	-	-	-	-
05100 - Menaxhimi i mbetjeve	508	503	503	503
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika	19	19	19	19
06260 - Shërbimet Publike Vendore	169	170	170	170
06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-	-	-

07220 - Shërbimet e Kujdesit Parësor	-	-	-	-
08130 - Sport dhe argëtim	30	28	28	28
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë	57	59	59	59
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit	435	441	441	441
09230 - Arsimi mesëm i përgjithshëm	80	78	78	78
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	160	160	160	160
10661 - Strehimi social	-	-	-	-
TOTALI	1,997	2,002	2,002	2002

Shpenzimet e personelit sipas programeve buxhetore për vitet 2023-2028 praqiten si në tabelën e mëposhtme :

Tabela: Shpenzimet e personelit për vitet 2023-2028(në mijë lekë)

EMËRTIMI I PROGRAMIT	Fakt 2023	Fakt 2024	Plani 2025	Plan i rishi kuar 2025	Plan 2026	Plan 2027	Pl an 20 28
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe	312,135	349,941	426,761	426,578	431,761	431,761	431,76
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	64,018	75,644	83,685	83,685	81,285	81,285	81,285
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	47,480	59,012	72,878	72,405	80,198	80,198	80,198
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik	-	-	-	-	-	-	-
04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi,	-	-	-	-	-	-	-
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	21,417	21,387	24,970	24,970	29,619	29,619	29,619
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	2,615	3,703	3,972	4,726	4,735	4,735	4,735
04520 - Rrjeti Rrugor	77,883	68,565	82,640	82,302	75,520	75,520	75,520
04570 - Transporti Publik	-	-	-	-	-	-	-
05100 - Menaxhimi i mbetjeve	329,867	357,554	427,537	426,510	425,877	425,877	425,87
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika	14,934	16,089	23,920	23,920	23,420	23,420	23,420
06260 - Shërbimet Publike Vendore	85,435	112,123	146,851	146,311	147,118	147,118	147,11
06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-	-	-	0	-	0
07220 - Shërbimet e Kujdesit Parësor	-	-	-	-	0	0	0
08130 - Sport dhe argëtim	23,065	23,949	27,161	27,161	26,440	26,440	26,440
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet,	50,070	53,489	60,697	60,697	62,149	62,149	62,149
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit	293,546	332,650	386,798	408,548	417,691	417,691	417,69
09230 - Arsimi mesëm i përgjithshëm	50,762	55,186	67,964	70,516	64,612	64,612	64,612
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	96,398	112,350	151,013	154,547	161,492	161,492	161,49
10661 - Strehimi social	-	-	-	-	0	0	0
TOTALI	1,469,624	1,641,642	1,986,847	2,012,876	2,031,917	2,031,917	2,031,9
<i>Në përqindje ndaj totalit</i>	42	43	36	31	30	30	29

Shpenzimet korrente (602-606)

Në këtë grup shpenzimesh bëjnë pjesë shpenzimet operative të mirëmbajtjes, blerje mallrash e shërbime, shpenzime për energji elektrike, ujë, telefon, internet, karburant, ushqimet e fëmijëve në kopshte e cerdhe, fonde subvencionime në ndihmë të familjeve në nevojë, shpërblime për nxënësit

ekselent, kuota e Qarkut, bursat ekonomike për nxënësit e shkollave 9 vjecare dhe të mesme që financohen nga buxheti i Bashkisë, kontrata e depozitimit të mbetjeve në landfillin e Sharrës, etj. Shpenzimet e këtij grupi për vitet 2026-2028 zënë përkatësisht: 26%, 26%, 26% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për secilin vit respektiv. Rritja e shpenzimeve korrente nga viti në vit është e qëndrueshme.

Fondi rezervë dhe i kontigjencës. (609)

Fondi rezervë për vitin 2026 është parashikuar në vlerën 260,050,899 lekë. Këtu është përfshirë edhe fondi prej 190,050,899 lekë i alokuar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rritjes së pagave. Ky fond do të përdoret me vendim të vecantë të Këshillit Bashkiak në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave që do të miratohen në funksion të rritjes së pagave. Edhe pjesa tjetër e fondit prej 70,000,000 lekë do të përdoret me vendime të vecanta të Këshillit Bashkiak për financimin e shpenzimeve të parashikuara në buxhet.

Fondi kontigjencës për vitin 2026 është parashikuar në vlerën 20,000,000 lekë dhe do të përdoret rast mbas rasti me vendime të vecanta të Këshillit Bashkiak.

Tabela: Shpenzimet e personelit për vitet 2023-2028 (në mijë lekë)

EMËRTIMI I PROGRAMIT	Fakti 2023	Fakti 2024	Plani 2025	Plani rishikuar 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe	167,267	226,637	128,293	173,468	170,117	170,117	170,117
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	11,676	3,140	13,400	19,465	15,000	15,000	15,000
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	8,163	14,793	34,630	36,256	36,000	36,000	36,000
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik	534	2,939	12,850	12,850	4,000	4,000	4,000
04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi	-	-	-	-	0		0
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	36,220	47,862	48,000	51,540	65,000	65,000	65,000
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	-	-	-	2,602	0	0	0
04520 - Rrjeti Rrugor	52,492	43,878	47,000	49,857	35,000	35,000	35,000
04570 - Transporti Publik	-	-	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
05100 - Menaxhimi i mbetjeve	552,271	574,073	560,584	576,616	506,933	506,933	506,933
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika	248	2,167	1,400	1,400	2,000	2,000	2,000
06260 - Shërbimet Publike Vendore	111,116	101,469	127,505	129,245	146,787	146,787	146,787
06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	-	-	-	-	0		0
07220 - Shërbimet e Kujdesit Parësor	-	-	-	-	0	0	0
08130 - Sport dhe argëtim	92,189	93,969	57,273	57,273	71,772	71,772	71,772
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet,	19,231	39,976	38,500	39,581	58,422	58,422	58,422
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit	107,983	134,046	177,214	188,336	193,188	193,188	193,188
09230 - Arsimi mesëm i përgjithshëm	31,101	37,173	45,245	47,138	49,918	49,918	49,918
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	33,933	40,776	55,495	55,629	59,528	59,528	59,528
10661 - Strehimi social	10,498	48,800	39,700	39,700	49,280	49,280	49,280
04910 - Fondi rezerve			37,000	63,332	260,051	260,051	260,051
04940 - Fondi kontigjences			16,000	16,000	20,000	20,000	20,000
TOTALI	1,234,922	1,411,698	1,470,088	1,590,287	1,772,996	1,772,996	1,772,996
<i>Në përqindje ndaj totalit</i>	35	37	27	25	26	26	26

Sikurse shihet peshën më të madhe e zënë shpenzimet në programin e menaxhimit të mbetjeve, të cilat pasohen nga ato për institucionet arsimore, duke filluar nga cerdhet e deri te shkollat e mesme.

Shpenzimet kapitale (230-231)

Në këtë grup shpenzimesh janë përfshirë projektet e investimeve, ndërtim rikonstruksione, blerje pajisje.

Për vitet 2026-2028 investimet publike janë planifikuar përkatësisht në masën: 44%, 45% dhe 45% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për secilin vit respektiv. Ato zënë peshën më të madhe në buxhet. Ato kanë burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë. Në planifikimin e investimeve për vitet 2026-2028 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve në vazhdim. Peshën specifike më të madhe e zënë investimet në infrastrukturë rrugore, që do të vijnë në financim nga fondet e veta të Bashkisë. Për vitin 2026 fondi për investime është 5.4% më i lartë se ai i vitit 2025.

Shpenzimet kapitale janë të shpërndara në 16 programe buxhetore dhe sipas programeve ato paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabela : Plani i shpenzimeve kapitale për vitet 2025-2026 (në mijë lekë)

EMËRTIMI I PROGRAMIT	Plani 2025	Plani 2025 rishikuar	Plani 2026	Plan i 2027	Plani 2027
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	99,284	100,556	185,297	0	0
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	721	1,884	0	0	0
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	0	13,100	92,610	0	60,000
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik	0	41,990	0	0	0
04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe	0	14,997	6,125		0
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	35,700	46,424	88,410	0	370,000
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	0	0	5,000	0	0
04520 - Rrjeti Rrugor	229,969	327,350	988,299	1,559,415	1,038,310
04570 - Transporti Publik	0	0	0	0	0
05100 - Menaxhimi i mbetjeve	3,910	29,910	18,090	70,000	0
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika	871,576	897,331	565,984	0	0
06260 - Shërbimet Publike Vendore	58,365	207,131	152,349	448,880	620,000
06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0	60,699	0		0
07220 - Shërbimet e Kujdesit Parësor	19,000	19,349	15,294	20,381	0
08130 - Sport dhe argëtim	0	122,653	170,353	216,365	50,000
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe	147,730	225,215	237,536	0	0
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit	349,125	434,813	194,295	359,894	779,640
09230 - Arsimi mesëm i përgjithshëm	127,133	297,062	248,323	224,327	0
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	2,300	2,300	9,947	0	0
10661 - Strehimi social	48,000	48,000	70,000	150,000	200,000
Totali	1,992,812	2,890,764	3,047,911	3,049,262	3,117,949

Në mënyrë të detajuar shpenzimet të detajuara sipas klasifikimit ekonomik për çdo program buxhetor jepen në raportin: PBA 3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik

4.3 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR

Projektet kryesore të investimeve me fondet e Bashkisë për vitet 2026-2028 janë:

- ✓ Përfundimi i rikonstruksionit të Pallatit të Kulturës “Aleksandër Moisiu” në vitin 2026
- ✓ Rikonstruksion i Pallatit të Sportit “Ramazan Njala” në vitet 2026-2027

- ✓ Rindërtimi i gjimnazit "Gjergj Kastrioti" në vitet 2026-2027
- ✓ Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare Bishtkamëz, i cili fillon në vitin 2026
- ✓ Brenda vitit 2026 përfundojnë godinat e reja të rindërtuara të shkollave: "Met Hasa", Shkolla 9 vjecare e Vadardhës, gjimnazi i Vadardhës.
- ✓ Përfundimi i rikonstruksionit të pallateve të dëmtuara nga tërmeti.
- ✓ Shpronësimi i 108 pasurive prone private që preken nga investimi i unazës së re të Durrësit.
- ✓ Ndërtimi i ri i godinave të shkollave: "Vasil Ziu" dhe "Nënë Terza", në vitet 2027-2028
- ✓ Rikonstruksioni rrugëve "A.Goga -Spitali" dhe "Kasem Durrësi" në vitet 2027-2028
- ✓ Vazhdojme me rikonstruksione të rrugëve në qytet dhe njësitë administrative, rehabilitime kuartallash, rehabilitim të rrjetit ndricues, shtim të sipërfaqeve të gjelbërta, rikonstruksion të fasadave, automjete për shërbimin zjarrfikës

Projektet e investimeve , në mënyrë të detajuar për çdo program janë paraqitur në Raportin PBA 8: Projektet e Investimeve, i gjeneruar nga SMBV, si dhe në pasqyrën nr.4 bashkelidhur projekt vendimit.

5. PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë Durrës menaxhohet sipas 22 programeve të shpenzimeve. Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Çdo nën-seksion (3.1 deri në 3.X) paraqet informacionin e performancës të planifikuar dhe kostot përkatëse për një program. Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve; dhe
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Tabela : Programet buxhetore për vitet 2025-2026 (në mijë lekë)

Nr.	PROGRAMI	FAKTI 2023	Fakti 2024	FILLEST AR 2025	RISHIK UAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
1	0110- Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	494,937	621,080	654,338	700,602	787,176	601,878	601,878
2	03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	75,694	78,784	97,806	105,034	96,285	96,285	96,285
3	03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	65,892	84,450	107,508	121,761	208,808	116,198	176,198
4	04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik	919	4,250	12,850	54,840	4,000	4,000	4,000
5	04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve	0	0	0	14,997	6,125	0	0
6	04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	95,425	71,278	108,670	122,934	183,029	94,619	464,619
7	04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	2,615	3,703		7,328	9,735	4,735	4,735
8	04520 - Rrjeti Rrugor	387,723	367,390	359,609	459,509	1,098,819	1,669,935	1,148,830
9	04570 - Transporti Publik	0	0	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
10	05100 - Menaxhimi i mbetjeve	965,717	932,478	992,031	1,033,036	950,900	1,002,810	932,810
11	06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika	17,100	169,818	896,896	922,651	591,404	25,420	25,420

12	06260 - Shërbimet Publike Vendore	401,715	380,465	332,721	482,687	446,254	742,785	913,905
13	06370 - Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0	0	0	60,699	0	0	0
14	07220 - Shërbimet e Kujdesit Parësor	0	0	19,000	19,349	15,294	20,381	0
15	08130 - Sport dhe argëtim	121,973	121,973	84,434	207,086	268,565	314,577	148,212
16	08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat	71,181	71,181	246,927	325,493	358,107	120,571	120,571
17	09120 - Arsimit bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	566,002	512,504	913,137	1,031,696	805,173	970,773	1,390,518
18	09230 - Arsimit mesëm i përgjithshëm	102,142	124,626	240,342	414,715	362,853	338,857	114,530
19	10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	130,742	153,655	208,808	212,476	230,968	221,021	221,021
20	10661 - Strehimi social	35,952	48,800	87,700	87,700	119,280	199,280	249,280
21	04910 - Fondi Rezervë	0	0	37,000	63,332	260,051	260,051	260,051
22	04940 - Fondi Kontigjencë	0	0	16,000	16,000	20,000	20,000	20,000
	TOTALI	3,535,729	3,826,739	5,449,747	6,493,926	6,852,824	6,854,175	6,922,862

Peshën specifike më të madhe në periudhën 2026-2028 e zë programi i infrastruktures dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor me 16% , programi i menaxhimit të mbetjeve me 14%, programi i arsimit bazë me 12%.

1. Programi i rrjetit rrugor

Për vitin 2026 buxheti për këtë program do të jetë 1,09 miliard lekë ose 139% më i lartë se buxheti i planifikuar për vitin 2025. Në këtë buxhet pjesën kryesore e zënë investimet në infrastrukturë rrugore me një vlerë prej 988 milion lekë dhe diferenca janë shpenzimet e personelit dhe operativet për Ndërmarrjen Rruga.

Një pjesë e rëndësishme e fondit të investimeve të infrastrukturë do të shkojë për shpronësimin e pasurive prone private që preken nga realizimi i projektit të ndërtimit të unazës së Durrësit. Vlera paraprake e shpronësimit është 880 milion lekë dhe prashikohet të financohet në 2 vite 2026-2027. Vlera e parashikuar për vitin 2026 është 400 milion dhe do të lëvrohet pasi të miratohet Vendimi i Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Investime të tjera për rrjetin rrugor për vitin 2026 janë :

- ✓ Ndërtimi i infrastruktures rrugore për njesitë e banimit në Ishëm me një sipërfaqe 27000 m².
- ✓ Rikonstruktion i rrugëve në Njesitë Administrative me një fond total prej 100 milion dhe për cdo njësi do të jetë 40 milion lek. Parashikohet të asfaltohen 15 km linear rrugë.
- ✓ Rikonstruktion i rrugëve, nyjeve të trafikut, trotuareve, sinjalistike me një fond total prej 100 milion lekë, i cili do të detajohet me vendim të vecantë.
- ✓ Fondi për Ndërmarrjen Rruga për blerjen e lëndëve për riparimin dhe asfaltimin e rrugëve, shesheve, trotuareve (asfalt, beton, inerte, gure kubike, rërë) do të jetë 92 milion lekë.
- ✓ Fondi për sinjalistikën e parkimeve me pagesë do të jetë 12.8 milion lekë . Parashikohet vijëzimi për 4582 poste parkimi dhe vendosja e 539 tabelave sinjalizuese.
- ✓ Fondi për sinjalistikën rrugore për Ndërmarrjen Rruga edhe për vitin 2026 do të jetë 20 milion lekë.

2. Programi i arsimit bazë

Buxheti për këtë program për vitin 2026 është 805 milion lekë dhe zë 12% të buxhetit të Bashkisë, duke u renditur i dyti për nga pesha specifike që ka në buxhet.

Me fondet e alokuara për këtë program gjatë vitit 2026 parashikohet :

- ✓ Financimi i shpenzimeve të personelit me një fond total prej 417.6 milion lekë për 441 punonjës të sistemit të arsimit parashkollor dhe bazë e konkretisht : 9 veta në administratën e QEA, 11 veta personel i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, 288 veta personeli i kopshteve (224 edukativ dhe 64 punonjës mbështetës) dhe 133 veta personel mbështetës për shkollat 9 vjecare . Financimi do të mbulohet nga transfertat sektoriale për arsimin baze në masën 94% dhe % nga të ardhurat e Bashkisë.
- ✓ Financimi i të gjitha shpenzimet operative që lidhen me funksionimin e 41 shkollave 9 vjecare me 16524 nxenes dhe 54 kopshteve (13 me ushqim dhe 41 pa ushqim) me 3346 fëmijë të moshës 3-6 vjec.
- ✓ Financimi i vakteve ushqimore të 1610 fëmijëve të shpërndarë në 13 kopshtet me ushqim dhe në shkollën PLM
- ✓ Do të kemi të përjashtuar nga pagesa e ushqimit në kopësht 108 fëmijë që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike, gra kryefamiljare, gra beqare, rom, aftesi ndryshe , binjak.
- ✓ Për vitin 2026 do të vazhdojmë të financojmë nxënësit e ekselencës. Me një fond prej 2.5 milion lekë do të shpërblejmë 60 nxenes të shkollave 9 vjecare. Ky projekt për shkollat 9 vjecare ka filluar në vitin 2022 dhe gjatë këtyre 4 viteve janë shpërblyer 272 nxenës.
- ✓ Për vitin 2026 do të vazhdojmë të mbështesim me bursa ekonomike nxënës që vijnë nga familje në nevojë sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 666 dt.10/10/2019. Do të përfitojnë bursa ekonomike prej 7319 lekë në muaj 550 nxenes të shkollave 9 vjecare. Bashkia do të financojë 288 bursa me një fond total prej 18.970.848 lekë, kurse Ministria e Arsimit do të financojë 262 bursa.
- ✓ Niveli i kopshteve të rikonstruara për vitin 2026 do të jetë 40.7 % pra do të kemi 22 kopshte të rikonstruara dhe synojmë që deri në vitin 2028 të shkojmë në 50% pra 27 kopshte.
- ✓ Niveli i kopshteve të rindërtuara për vitin 2026 do të jetë 46.3 % ose 25 kopshte dhe në 2028 të kemi realizuar 48.1% ose 26 kopshte.
- ✓ Fondi aktiviteteve dhe kurseve jashtëshkollore për Qendrën Kulturore të Fëmijëve me synim shfrytëzimin me kapacitet të plotë të Qendrës Kulturore të Fëmijëve do të dy fishohet. Fondi total për funksionimin e Qendrës për vitin 2026 do të jetë 12 milion lekë. Numri i fëmijëve që ndjekin kurset jashtëshkollore pranë kësaj Qendre për vitin 2026 parashikohet të jetë 700 fëmijë.
- ✓ Do të fillojë ndërtimi i shkollës 9 vjecare Bishtkamëz
- ✓ Brenda vitit 2026 përfundojnë ndërtimi i shkollave 9 vjecare “Met Hasa” dhe Vadardh Njesia Administrative Sukth
- ✓ Do të përfundojë rikonstrukcioni i shkollës “Bajram Curri”.

3. Programi i arsimit të mesëm

Buxheti për këtë program për vitin 2026 do të jetë 260 milion lekë dhe zë 5% të buxhetit të Bashkisë.

- ✓ Do të financojmë personelin mbështetës të shkollave të mesme prej 48 veta me një fond total prej 35.1 milion lekë. 70% e shpenzimeve të personelit financohet nga transfertat sektoriale për këtë qëllim dhe 30% nga të ardhurat e Bashkisë.
- ✓ Me një fond prej 22 milion lekë do të financojmë shpenzimet operative për funksionimin dhe mirëmbajtjen e 13 shkolla të mesme dhe të mesme të bashkuara me një numër prej 4046 nxënës.
- ✓ Me një fond prej 46.4 milion lekë do të financojmë funksionimin e plotë të dy konvikteve të rindërtuara. Në këtë fond janë të përfshira shpenzimet e personelit të konvikteve prej 30 vetash, si dhe shpenzimet operative. Financimi është 46 % nga transfertat sektoriale për konviktet dhe 44% nga fondet e Bashkisë. Në të dy konviktet janë të akomoduar 150 nxënës.
- ✓ Do të vazhdojmë të financojmë nxënësit e ekselencës. Fondi i planifikuar për vitin 2026 për këtë qëllim është 2.5 milion lekë dhe parashikohen të shpërblehen 60 nxenes . Numri i nxënësve të shpërblyer që nga viti 2018, pra gjatë këtyre tetë viteve është 288 nxënës, nga të cilët 31 nxënës fitues të Medaljeve të Arit, 97 nxënës ekselentë në 100 më të mirët e maturës shtetërore dhe 160 nxënës fitues olimpiadash.

- ✓ Per vitin 2026 do të vazhdojmë të mbështesim me bursa ekonomike nxënës që vijnë nga familje në nevojë sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 666 dt.10/10/2019. Do të përfitojnë bursa ekonomike prej 7319 lekë në muaj 165 nxënës të shkollave të mesme. Bashkia do të financojë 127 bursa me një fond total prej 8,417,907 lekë, kurse Ministria e Arsimit do të financojë 38 bursa.
- ✓ Gjatë vitit 2026 përfundon ndërtimi i gjimnazit Manëz.
- ✓ Gjatë vitit 2026 do të kemi 60% të shkollave të mesme të rindërtuara dhe 33% të rikonstruktura dhe deri në fund të vitit 2028 me rindërtimin e Gjimnazit "Gjergj Kastrioti" të gjitha shkollat e arsimit të mesëm do të jenë plotësisht të rindërtuara apo rikonstruktura.

4. Programi i mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri

Buxheti për këtë program për vitin 2026 rritet me 72% dhe kap vlerën 208 milion lekë.

- ✓ Do të shtohet personeli zjarrfikës me 8 veta duke e çuar në 64 personelin e shërbimit të MZSH.
- ✓ Do të shtohet flota e automjeteve të MZSH-së me 3 automjete : zjarrfikëse e madhe, zjarrfikëse e vogël dhe autobot.
- ✓ Fondi i investimeve për MZSH do të jetë 92.6 milion lekë.
- ✓ Fondi për dëmshpërblimin e familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore si zjarre, përmbytje do të jetë 15 milion lekë.

5. Programi i shërbimeve sociale

Buxheti i këtij programi për vitin 2026 do të jetë 230.9 milion lekë, 8 % më i lartë krahasuar me vitin 2025.

- ✓ Për vitin 2026 kemi 7 qendra sociale të financuara nga Bashkia me një fond total prej 71.3 milion lekë duke iu ofruar shërbime 1124 personave në vit.
- ✓ Qendra "Forcojmë komunitetin" do të vijojë të bashkëfinancohet edhe me fondin social të alokuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Fondi i Bashkisë për këtë Qendër është 14.784.000 lekë.
- ✓ Me një fond prej 7.200.000 lekë nga të ardhurat e Bashkisë do të financohen me ndihmë ekonomike 140 familje.
- ✓ Do të vazhdojmë me pagesat e komisioneve të pagesave pranë Postës shqiptare për personat me aftësi të kufizuara, gjithsej përfitojnë 6582 persona.
- ✓ Do të mbështesim projektin "Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje" me një fond total prej 2.694.000 lekë.
- ✓ Për vitin 2026 do të financojmë funksionimin e 6 cerdheve, pesë nga të cilat janë në qytet dhe 1 cerdhe e re që sapo është hapur në Manëz. Fondi total për cerdhet 137 milion lekë, nga të cilat 109.6 milion lekë janë për shpenzime personeli për 110 veta . Fëmijë të regjistruar në cerdhe janë 696 .

6. Programi i strehimit social

Buxheti i këtij programi për vitin 2026 do të jetë 119 milion lekë, 36 % më i lartë krahasuar me vitin 2025.

- ✓ Do të financohet bonusi i qerasë në masën 40% për 380 familje me një fond total prej 15 milion lekë
- ✓ Është viti i parë që do alokojmë një fond të dedikuar për bonus qeraje për gratë me urdhër mbrojtje. Ky fond do të jetë 5 milion lekë dhe parashikohet për 64 gra.
- ✓ Do të subvencionohen interesat e kredisë për 79 persona me një fond total prej 2.5 milion lekë.
- ✓ Vazhdon pagesa e transheve të kredisë së CEB-it për ndërtimin e banesave me qëllim social me një fond prej 23.5 milion lekë. Kjo kredi përfundon në vitin 2030.

- ✓ Është parashikuar fond prej 3.2 milion lekë për mirëmbajtjen e 342 banesave sociale.
- ✓ Është parashikuar fond prej 10.000.000 lekë për projektin: "Përmirësimi i kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese të familjeve në nevojë (bashkefinancim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit)". Vlera e plotë e projektit që do të prokurohet është në varesi të fondit që do të alokohet nga MEKI.

7. Programi i Sportit

Buxheti i këtij programi për vitin 2026 do të jetë 268.5 milion lekë, 29 % më i lartë krahasuar me vitin 2025

- ✓ Do të financojmë 62 sportistë dhe 12 trajnerë të klubit të shumësporteve të disiplinave të ndryshme sportive me një fond total prej 26.95milion lekë. Përzgjedhja e tyre do të bëhet sipas kriterëve që do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak.
- ✓ Për herë të parë do të mbështesim edhe ekipin e futbollit për femra.
- ✓ Në vitin 2026 do të fillojë rikonstruksioni i plotë i Pallatit të Sportit "Ramazan Njala" dhe parashikohet të financohet në 2 vite, 2026 dhe 2027.

8. Programi i Kulturës

Buxheti i këtij programi për vitin 2026 do të jetë 358 milion lekë, 10 % më i lartë krahasuar me vitin 2025.

- ✓ Në janar të vitit 2026 përfundon rikonstruksioni plotë i Pallatit të Kulturës "Aleksandër Moisiu" dhe është parashikuar një fond prej 50 milion lekë për mobilimin e Pallatit të Kulturës
- ✓ Brenda vitit 2026 përfundon rikonstruksioni i Mazoleumit të Dëshmorëve
- ✓ Është parashikur fond për hartimin e projektit për ndërtimin e një Biblioteke, pasi godina ekzistuese e Bibliotekës është me pronar dhe është tejet e amortizuar,
- ✓ Me qëllim rritjen e numrit të koncerteve që do të realizojë Orkestra frymore e qytetit është parashikuar që shpërblimi mujor i instrumentistëve dhe dirigjentit të saj orkestrës të rritet mesatarisht 2.7 herë më shumë se pagesat aktuale. Është parashikuar të realizohen 8 koncerte në vit. Fondi total për shpërblimin e tyre është 6.9 milion lekë, rreth 2 herë më i lartë se viti 2025.
- ✓ Forma e shpërblimit për orkestrën e harqeve ndryshon, nga një pagesë fikse mujore bëhet pagesë për koncert dhe parashikohen 8 koncerte në vit. Ky fond për vitin 2026 është planifikuar 5.6 milion lekë, rreth 2 herë më i lartë se viti 2025.
- ✓ Fondi për thirrjen e projekteve kulturore është planifikuar 20 milion lekë në të njëjtin nivel me vitin 2025.
- ✓ Fondi për shpenzime për funksionimin e Qendrës Kulturore përfshirë edhe projektet kulturore që realizon kjo Qendër, për vitin 2026 do të jetë 19.8 milion lekë, ose 11.4 milion lekë më shumë se viti 2025.

9. Programi i Menaxhimit të ujitjes dhe Kullimit

Buxheti i këtij programi për vitin 2026 do të jetë 183 milion lekë, 50% më i lartë krahasuar me vitin 2025.

- ✓ Për vitin 2026 fondi i investimeve për këtë program do të jetë 88 milion lekë për financimin e projekteve në proces nga viti 2025 si :

1. Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve në Fshatin Rrushkull
2. Sistemin K.U.B në rrugën "Taulantia", Lagjja Nr.1
3. Rehabilitim i kanalit të ujerave të larta Spitalle -Porto Romano (Faza 3)

- ✓ Për vitin 2026 fondi që i alokohet Ndërmarrjes Rruga për financimin e këtij funksioni (shpenzime personeli dhe operative) është 94.6 milion lekë. Ky është funksion që financohet nga transfertat sektoriale për ujitjen dhe kullimin në masën 61% dhe 39% nga të ardhurat e Bashkisë. Parashikohet të pastrojnë rreth 67 km linear kanale.

10. Programi i Administrimit Pyjeve

- ✓ Për vitin 2026 është parashikuar të realizohet hartimi I planit... në bashkëpunim me UB me një fond limit prej 5.000.000 lekë dhe do mbulojë 2 ekonomi pyjore.

11. Programi i menaxhimit të mbetjeve

Buxheti i këtij programi për vitin 2026 do të jetë 950 milion lekë. Në këtë program janë përfshirë fondet që alokohen për 2 ndërmarrjet: Ndërmarrja Komunale Plazh dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale që realizojnë pastrimin e territorit, largimin e mbeturianve dhe depozitimin e tyre në landfillin e Sharrës.

- ✓ Fondet për të dy ndërmarrjet për shpenzime korrente dhe personeli në total për vitin 2026 janë parashikuar 689.87 milion lekë.
- ✓ Fondi për investime është 18.9 milion lekë me të cilin parashikohen të blihen 300 kazane, 600 kosha të vegjël për shëtitoret, si dhe vendosja e 50 kamerave vrojtuese në pikat e vendgrumbullimeve të mbetjeve.
- ✓ Fondi për pagesën e depozitimit të mbetjeve në Sharrë për vitin 2026 është 242.9 milion lekë për 72101 ton në vit. Kjo vlerë financohet nga transfertat sektoriale që alokohen nga buxheti i shtetit për këtë qëllim në masën 92.6 % ose 225.1 milion lekë dhe 7.4% ose 17.8 milion lekë do të financohen nga të ardhurat e Bashkisë